

KONTRATE PER SHITBLERJEN E KUOTES

Sot me 28.07.2017, eshte nenshkruar kjo kontrate per shitjen dhe transferimin e pjesemarrjes ne kapitalin themeltar te shoqerise 23OPTION shpk (ketu e me poshte quajtur "**Kontrata**") ndermjet:

Z. Irvelin Gjonaj, shtetas shqiptar, lindur me 12.03.1981, ne Librazhd, banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i leternjofimit me nr. I10312214F, zoterues i 1 kuote qe perfaqeson 33,33 % te Kapitalit te Regjistruar te Shoqerise, perfaqesuar nga Zoteruesi Aktiv i Kuotave **Z.Roland Asqeriu**, sipas Marreveshjes se Zoterimit Pasiv te Kuotave date 22.05.2017 (ketu e me poshte quajtur "**Shitesi**").

Dhe

Z. Roland Asqeriu, shtetas shqiptar, lindur me 02.04.1990, ne Fier, banues ne Durres, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i leternjofimit me nr. J00402115T (ketu e me poshte quajtur "**Bleresi**");

Palet e mesiperme, te kesaj Kontrate, do te referohen se bashku si "**Palet**".


MEQENESE:

- A. 23OPTION shpk ("**Shoqeria**"), eshte nje shoqeri shqiptare me pergjegjesi te kufizuar, regjistruar rregullisht ne Regjistrin Tregtar, ne Qendren Kombetare te Biznesit me numer unik NIPT L62025015J, date 25.08.2016, me seli ne adresen Rr. Shkelqim Fusha, Ambjenti me Nr.Pasurie 104/87-N10, Zona Kadastrale Nr.3292, vol.50, Fq.73, prane Kopshut Botanik, Tirane, me kapital themeltar 100 Leke, te ndare ne 3 kuota;
- B. Kuotat e shoqerise jane ne pronesi te :
 - (i) *Z. Fation Elezaj, zoterues i 1 kuote qe perfaqeson 33,34 % te Kapitalit te Regjistruar te Shoqerise;*
 - (ii) *Z. Roland Asqeriu, zoterues i 1 kuote qe perfaqeson 33,33 % te Kapitalit te Regjistruar te Shoqerise;*
 - (iii) *Z. Irvelin Gjonaj, zoterues i 1 kuote qe perfaqeson 33,33 % te Kapitalit te Regjistruar te Shoqerise;*
- C. Ortaku Irvelin Gjonaj perfaqesohet nga Zoteruesi Aktiv i Kuotave **Z.Roland Asqeriu**, sipas Marreveshjes se Zoterimit Pasiv te Kuotave date 22.05.2017;
- D. Ortaku Irvelin Gjonaj, deshiron te transferoje pronesine, permes shitjes se kuotes qe perfaqeson 33,33 % te pjesemarrjes se tij ne Kapitalin Themeltar te Shoqerise, tek Bleresi Roland Asqeriu;
- E. Transferimi sipas kesaj kontrate eshte miratuar me Vendim te Asamblese se Shoqerise, ne perputhje me nenin 12 te Statutit.

Sa me sipër, ne baze te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, Statutit te Shoqerise dhe neneve 705 e vijues te Kodit Civil te RSH, Palet bien dakort si me poshte vijon:

NENI 1 OBJEKTI I KONTRATES

- 1.1 Objekti i kesaj Kontrate eshte transferimi i pronesise, permes shitjes, i kuotes qe perfaqeson 33,33 % te pjesemarrjes se Ortakut Irvelin Gjonaj ne kapitalin themeltar te Shoqerise, tek Bleresi;
- 1.2 Per sa me sipër, Shitesi shet dhe transferon dhe Bleresi pranon pronesine e pjesemarrjes ne kapitalin themeltar te Shoqerise, sipas paragrafit 1.1 me sipër, si dhe te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kjo pronesi.
- 1.3 Per shkak te kesaj Kontrate, Marreveshja e Zoterimit Pasiv te Kuotave date 22.05.2017, perfundon efektet ligjore.



NENI 2
ÇMIMI I SHITJES, PAGESA

2.1 Shitesi do të transferojë dhe shesë kuotën e tij në favor të Blerësit, kundrejt çmimit prej 10 000 Euro (“**Çmimi i Shitjes**”).

2.2 Çmimi i Shitjes do të paguhet nga Blerësi, në llogarinë bankare të Shitesit, menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate.

NENI 3
REGJISTRIMI

3.1 Palet pranojnë të zbatojnë dhe japin, me kërkesë të palës tjetër dhe/ose Shoqërise, të gjithë dokumentacionin e duhur në përgjithësi, për të kryer çdo gjë të nevojshme për transferimin e pjesëve të kapitalit, që janë objekt i kësaj kontrate dhe për të regjistruar këtë transferim në Regjistrin Tregtar të Qendres Kombëtare të Regjistrimit si dhe në çdo organ tjetër shqiptar sipas ligjeve shqiptare në fuqi.

NENI 4
TE NDRYSHME

4.1 Palet garantojnë se ata e kanë lexuar dhe kanë kuptuar kontratën dhe nenet e saj.

4.2 Kjo kontratë është përgatitur në 3 kopje, në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtte ligjore.


Kontrata u lexua përpara Paleve, u gjend në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plote dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre.

SHITESI
IRVELIN GJONAJ
Perfaqësuar nga Zoteruesi Aktiv
Roland Asqeriu


(emër, mbiemër, nënshkrim)



BLERESI
ROLAND ASQERIU


(emër, mbiemër, nënshkrim)

